

PROPOZIM

Për emërtim rruge

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Shkodër

Të nderuar këshilltarë,

Në cilësin e anëtarit të këshillit bashkiak Shkodër, bazuar në nenin 54 shkronja “l” dhe në ligjin për sistemin e adresave, propozoj emërtimin e një rrugice me emrin Pjetër Gjini.

Bashkëlidhur me propozimin gjeni edhe jeteshkrimin e Pjeter Gjini dhe një mbështetje të këtij propozimi edhe nga shoqata kulturore artistike “Prenke Jakova”-Shkodër.

Bashkëlidhur edhe një foto e rrugices së propozuar për tu emërtuar “Pjeter Gjini”

Me konsideratë

Ali Tula

Anëtar i Këshillit Bashkiak Shkodër

VENDITJE, UDHEZIME, SHKRESA, KERKESA
NR. 20893 DATE 18.12.2018
DERSUAR NGA:
L E N D A :

OROSIA E TITULLARIT:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E STUDIMEVE PLANIFIKIMIT DHE KOORDINIMIT TE INVESTIMEVE

Nr. 6060 Prot.

Shkodër 11 / 04 2019

Lënda: Kthim përgjigje shkresës tuaj Nr 893/b,Dt 08.03.2019 në lidhje me kërkesën "Vlerësim-Teknik,për emërtimin e një Rruge në Njësinë Administrative Shkodër.

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Shkodër. ✓

Me shkresën Nr 893/b,Dt 08.03.2019,,ju kërkoni Vlerësimin Teknik për emërtimin e një Rruge me emrin "Pjetër Gjini",në lidhje me këtë ju bëjmë me dije se:

Kërkesa juaj për plotësimin e kriterëve teknike për të marrë emërtim në një një degëzim të Rr" Marin Biçikemi" sipas ekstraktit bashkangjitur,plotëson kriteret e parashikuara në nenin 6 të Ligjit Nr 9270,Dt 29.07.2004"Për Sistemin e Adresave"duke ju referuar edhe sistemit aktual të Adresave miratuar nga Këshilli Bashkiak Shkodër Nr 117 Dt 24.11.2009.

Bashkangjitur shkresës ju vëmë ne dispozicion ekstraktin e hartës.


Duke kërkuar mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.



KRYETARI


Voltana ADEMI

Lodovik Saraçi



SHKURTESI
RIPRISE



**SHOQATA KULTURORE ARTISTIKE
"PRENKE JAKOVA,,
SHKODER**

Adresa: L.'Gjuhadol' Rr.'Berdicej'Nr.130 Shkodër AL.
Tel. +335 02282228 Cel. 0693866873
E-Mail: gjonshllaku@gmail.com

KERKESE

DREJTUAR: Këshilli Bashkiak Shkodër

Shoqata kulturore Artistike "Preнке Jakova" parshtron para Këshillit Bashkiak Shkodër kërkesën për dhënien e emrit të shkrimtarit, poetit, humoristit të persekutuar nga regjimi komunist z. Pjetër Gjini (pas vdekjes) të një rruge në qytetin e Shkodrës.

Duke parë kontributin e paçmuar dhe të pavlerësuar që ai zhvilloi gjatë jetës së tij, si një qytetar që gëzoi të mëdhej e të vegjël, që hyri pothuajse në gjithë shtëpitë e shkodranëve për gëzimet e tyre, që u mësoi krejt falas sa e sa njerëzve gjuhën italiane, mendojmë se meriton të përjetsohet në emrin e një rruge të qytetit tonë.

Me shpresë në miratimin e kërkesës sonë, ju uroj punë të mbarë.

Për Shoqatën Kulturore Artistike
"Preнке Jakova"

Gjon Shllaku
(presidenti shoqatës)



Shkodër 05/04/2018


- PJETER GJINI -

Lindi ne Shkoder ne nji familje qytetare me 18 nandor 1910. Studioi ne kolegjin Saverian ku u shqua si student shembull. Mesoi mire mesimet si dhe muzike, u shqua ne mesimin e kitarres ne rrang shoqnimi. Per aftesite e tij si talent muzike dhe aftesi organizimi, u afrua ne radio Tirana per te drejtu programin " Ora gazmore " Vazhdon keshtu deri ne prag te vitit 1945, vit kur u perjashtua nga kjo radio dhe ju dha drejtesise per denim per axhitacion e propagande kunder pushtetit. Ban afersisht 15 vjet burg dy heresh dhe ne vitin 1967 del nga burgu dhe vendoset ne Shkoder. Jeton me ndihmat e nipave e mbesave deri sa me 30 mars 1988 ndrron jete.

Ka shkru mjaft kange e libra, nga librat mjafton te permendi 12 librat qe me vendim te gjykates Tiranes me 27 mars 1948 u ndaluan nga qarkullimi.

Ka marr pjese ne gezimet e shum e shum shkoderaneve ne raste ditlindjesh, fejesash ,darsmash e gezime te tjera, pa dallim fejet, kudo ku e njifshin dhe e thirreshin. Un qe shkruaj, kam ba pjese ne nji grup muzikore dhe me PJETRIN kena kene prezent ne shum raste te tilla. Ka pase raste qe ne nji shtepi te kena shku edhe per here te dyte e te trete. Ishte i veçante ne aktivitetin qe zhvillonte ne kesi rastesh. Nuk kishte za te bukur kush e di se çfar por printe ne kanget qe kendonte dhe bante te gjith te merrshin pjese ne darsen, jo vetem tuj hanger. Rrepertor shum i pasun me kange shkoderane, disa kange humoristike te tij, ndonji muzike te lehte italiane dhe ma vone fillonte te vinte " ne loje " ndonjenin me bejta, fushe ku ishte mjeshter i vertete. Per tu theksu nji fakt : Ne shum raste na ka " detyru " edhe ne te orkestres te bajme si Ai, te mos merrshim shperblimin per punen e kryeme me justifikimin " jane njerzit e mij " apo " jan fukara". Ai asnji here nuk pranoi te merrte lek per punen e Tij, ndonese nuk kishte asnji mjet jeteset si asistence apo te ardhun tjetër. Leket qe i takojshin Atij i merrte fizarmoniçisti dhe me marifet ja çonte tek mbesa ku jetonte. Ndonji here qe e merrte vesht, ju kethente fizarmoniçistit(Ferdinand Shllaku) : " Prep ma ke marre ftyren?"

Me ka rastise ne shtepin teme, me 27 nandor 1983. Djali jem mbushte 10 vjeç dhe vendosa me thirre perveç te afermve, edhe pjestaret e orketres me gra. I tham edhe Pjetrit. Me thote me vjen shum keq por s'ka pak qe me ka vdeke nipi e nuk mundem me ardhe. Ne oren 21 do mblidheshim. Te gjith kishin ardhe kur ne 20 e 45 bjen zilja e deres. E hapi, Pjetri me kitarre ne dore, me perqafon e me thote " Tuj e dijte qe jeni mbledhe, nuk mujta me mungu " Mjafton me pyet né Shkoder ende sot kush ishte Pjeter Gjini, edhe ato që nuk e kanë njoftë personalisht dinë me tregu nga që asht kthy né "Mit"



Poezi improvizu nga Pjeter Gjini me 1943 mbas shperthimit te
nji bombe afer Radio Tiranes

Vesht' e mi tash jan shurdhue
Kerkoj vedin s'e gjej kund'
Mikrofoni ka flutru,
Prej karrige kam ra bum.

Po vazhdojm oren e gazit,
Me ma t'kandshmen er'te blinit,
Qe na fal'praver'e marsit,
Edhe ora e Pjeter Gjinit.



Shkru ne burg ku kaloi 12 vjet. Asht " frymezu " nga poezia " Vaji
i bylbylit "

Bylbyl sot s'ta din kush vleren,
Per kyt fjale mos mbaj maraz,
Tash qe mbyll na kan dhe deren,
Bashke leht' do t'kendojm n'kafaz.

Mu kitarren ma kan " tret "
Si t'kan hjek dhe ty lirin
Pranvera per ty asht djege,
E per mu u kthye n'shkreptim.

Per mue Zoti paska thane,
"Ne kafaz me ty me kendue",
Dymbedhjet vjet e mjera nane,
Zanin tem s'ma ka ndigjue.



Libra te ndaluem nga qarkullimi me date 27 mars 1948,
Me vendim te gjykates:
PJETER GJINI

01. BESNIKU
02. FLETORJA E KLERIT KATOLIK.
03. FASHIZMI
04. FJALIMI I PATER ANTON HARAPIT
05. FJALIMI I KONTIT CIANO
06. FLAMURI I SHEJTE
07. FRUSHULLIME
08. KENGE TE REJA
09. KURTHA E DASHURISE
10. MALSORI NE PARIS
11. ORA E DESHIRUEME
12. TRIDHJET E DYSHI.